

STATUT AKT - THEMELIMI

1 SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "KUQ E ZI TAKSI" SH.P.K.

Sot, më datë 06.05.2024, Ortakët e shoqërisë "KUQ E ZI TAKSI" SH.P.K, Aristidh Dh. Nikollari dhe Kristaq N. Jano, bazuar në vullnetin e tyre të lirë themeluan shoqërinë "KUQ E ZI TAKSI" SH.P.K., në përputhje me Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, dhe vendosën të hartojnë këtë statut për funksionimin e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "KUQ E ZI TAKSI" SH.P.K.

KREU I

THEMELIMI, EMRI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më 06.05.2024 ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "KUQ E ZI TAKSI" SH.P.K.

Themeluesit e shoqërisë janë:

Z. Aristidh Nikollari, i biri i Dhionisit, i datëlindjes 09.03.1960, mbajtës i dokumentit ID me numër 034021303 dhe Numër Personal G00309108P, lindur ne Vlore dhe banues në Tirane.

Z. Kristaq Jano, i biri i Nikolla, i datëlindjes 24.01.1977, mbajtës i dokumentit ID me numër 038034926 dhe Numër Personal: H70124088E, lindur në Gjirokastrë dhe banues në Tiranë.

Neni 2

Selia

Selia juridike e shoqërisë, ndodhet në Tiranë, Njësia Administrative Nr. 14, Rruga "Shkëlqim Fusha", ZK 3292, Pasuria Nr. 102/14-N11, Selite, Tirane.

Shoqëria me miratimin e organeve kompetente, mund të krijojë qendra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi e agjenci në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.

Neni 3

Kohëzgjatja

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetet saj për një periudhe kohore te papërcaktuar.

Neni 4

Objekti

Shoqëria do te kryejë aktivitetin e mëposhtëm:



Shërbime ne fushën e transportit të udhëtareve, shërbim Taxi 4+1 e Radio-Taxi, për te gjithë mjetet e taksive. Shërbim taksi i një niveli të larte bashkëkohor, me një nivel te larte dhe trajnimi te vazhdueshëm të personelit te shërbimit (shofer), operator te vazhdueshëm taksi me një pakete te përshtatshme ne ndihme te mbrojtjes se ambientit, studime dhe menaxhim te vazhdueshëm te tregut, pajisjen e automjeteve me GPS, dërgimit te mjetit duke minimizuar kohen e pritjes. Shërbime taksi për publikun brenda dhe jashtë territorit te Shqipërisë.

Transporti urban dhe interurban në funksion te shërbimit Taxi te udhëtarëve, në përputhje me çdo ligj te zbatueshëm dhe rregullore te fushës përkatëse. Shoqëria mund te marre pjese në shoqëri te tjera qe kane objekt te ngjashëm me te.

Dhënie me qira e makinave, motorëve, minibus, autobus personave te trete. Tregtim, shërbim me qira me drejtues mjete. Tregtim blerje dhe shitje automjetesh

Shoqëria mund te kryeje edhe aktivitete te tjera, te marre pjese ne sipërmarrje te tjera brenda dhe jashtë vendit ne përputhje me legjislacionin ne fuqi.

KREU II KAPITALI

Neni 5 Kapitali themeltar

Kapitali fillestar i shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre.

Ortakët themelues janë:

Z. Aristidh Nikollari, zotërues i 1 (një) kuote të kapitalit, me vlerë 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë, e cila përbën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Z. Kristaq Jano, zotërues i 1(një) kuote të kapitalit, me vlerë 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë, që përbën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 6 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund te zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve te pjesëve te kapitalit themeltar për kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nëpërmjet emërimit te një eksperti te autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës se administratorit.

Ne asnjë rast, shumica nuk mund te detyroje një ortak për te rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar te shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet nga Asambleja e Ortakeve ne te njëjtat kushte qe kërkohen për ndryshimin e statutit. Ne te gjitha rastet zvogëlimi i kapitalit i prek ne te njëjtën mase ndaj pjesëve te kapitalit qe përfaqëson

Neni 7 Transferimi i kapitalit



Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet Ortakeve përderisa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8 Organi Vendimmarrës


Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është organi vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimin e statutit
- c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të eksperteve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të këtij neni;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblesë të përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.



Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme, me përjashtim të rastit kur është vetë në cilësinë e ortakut.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme e Ortakëve

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose nëpërmjet postes elektronike. Njoftimi duhet me shkresë ose mesazh elektronik, duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes, rendin e ditës dhe t'u dërgohet të gjithë ortakëve jo më vonë se para 7 dite përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur, asambleja e përgjithshme e ortakëve nuk është thirrur sipas kësaj mënyrë, ajo mund të marrë njoftime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme e ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë me shume se 50% të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë me shume se gjysma e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit sipërmendur.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 dite, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e Vendimeve

Asambleja e përgjithshme e Ortakëve, vendos me tre të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera, si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ernërimin dhe shkarkimin e administratorit;
- c) emërimin dhe shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar,
- d) përcaktimin e shpërblimeve
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB-se për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 12
Përjashtimi nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtroje të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padije ndaj tij nga shoqëria;
- d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një i përfaqësuar i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në t njëjtin konflikt interesi, ashtu siç është dhe ortaku, të cilin përfaqëson.


Neni 13
Administrimi

Administrator i shoqërisë emërohet:


Z Kristaq Jano, i biri i Nikolla, i datëlindjes 24.01.1977, mbajtës i dokumentit ID me numër 038034926 dhe Numër Personal: H70124088E, lindur në Gjirokaster dhe banues në Tiranë.

Z. Kristaq Jano, emërohet në këtë detyrë për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Emër Mbiemër



Nenshkrimi




Administratori i shoqërisë mund të emërohet edhe një person i tretë jashtë ortakërisë.

Neni 14
Kompetencat e Administratorit

Administratori ka këto përgjegjësi::

- a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme ;
- b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) të kujdeset për mbajtjen e sakte e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) të përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto
- e) dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- f) dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;





- g) te krijoje një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- h) te kryejë regjistrimet dhe dërgojnë te dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në
- i) ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- j) te raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe
- k) me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- l) te kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligji dhe në statut.
- m) Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm.
- n) Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaja, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve.
- o) Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretet në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë.
- p) Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretet nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Nëse Asambleja e Përgjithshme emëron me shume se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin e shoqërisë në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Padite që lidhen me shpërbllimin e administratorit, në baze të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe Ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

1. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:
 - a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligji dhe statut mirëbesim e në interesin me të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligji dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të
 - c) përcaktuara në këto dispozita;
 - d) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

- e) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo te mundshëm, te interesave
 - f) personale me ata të shoqërisë;
 - g) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në baze të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave I e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë demet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime te parregullta. Administratori ka barrën e provës për te vërtetuar kryerjen e detyrave te tyre ne mënyrë te rregullt e sipas standardeve te kërkuara. Kur shkelja është kryer nga me shume se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
4. Në mënyrë te veçantë, por pa u kufizuar ne to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë demet e shkaktuara, nëse, kundërshtim me dispozitat ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
- a) u kthen ortakëve kontributet;
 - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej te parashikohej që shoqëria nuk do te kishte aftësi paguese për te shlyer detyrimet;
 - e) jep kredi.

KREU IV VITI FINANCIAR- EKSPERTËT


Neni 16 Viti Financiar

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, Viti i parë financiar, fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, miraton Llogarite vjetore të paraqitura nga Administratori, vendos për krijimin e fondit rezerve, fondeve për investime, si dhe destinime te tjera te fitimit ose humbjes së vitit ushtrimor.

Neni 17 Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që te kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike te



ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë. i ngarkuar nga ana e ortakeve

Ne përfundim të kontrollit, eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor, si dhe për atë për kontrollet periodike të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzohë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

KREU V PRISHJA - RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 18 Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e Saj;
- b) me vendim të Asamblesë Se Ortakeve
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) e) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- e) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese " Shoqëri në likuidim e sipër ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur Është nisur një procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.


Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19 Riorganizimi i shoqërisë: Bashkimi - Ndarja

Shoqëria mund të ndahet bashkohet sipas vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakeve në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

Neni 20 Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.



Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.


Neni 21
Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tremeve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKËT
E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"KUQ E ZI TAKSI" SH.P.K

Ortaku/Themelues, Aristidh Dh. Nikollari



Ortaku/Themelues, Kristaq N. Jano

